

Sapo ishte kthyer nga Anglia, plagoset me armë zjarri 33 vjeçari në Dimal

May 21, 2021 21:42



Nga Arkiva

- Shkodër, plagosen dy persona në një aksident rrugor 14.Aug
- Berisha kundër "Primit" : Rama më çoi sekserë për Primin, por jam për proporcionalin 03.Nov
- PD: Deputetët, pro djegies së mandateve, Këshilli do ta vendosë 18.Feb

Shtetasi Iliaz Ismaili, 33 vjeç ka mbetur i plagosur me armë zjarri mbrëmjen e sotme. Ngjarja ka ndodhur në një nga lokalet më me zë në zonën e Dimalit, me emrin “Kështjella”, që ndodhet në fshatin Poshnje.

Mësohet se Ismaili kishte vetëm pak ditë që ishte kthyer nga Mbretëria e Bashkuar. 33-vjeçari kishte dalë pasditen e sotme të kalonte pak kohë me të afërmit e tij, konkretisht në lokalin e xhaxhait të tij.

Rreth orës 18:00, Ismaili u qëllua me armë zjarri nga persona që ende nuk janë identifikuar dhe mbeti i plagosur. Ai u dërgua në spitalin e Beratit ku po merr ndihmë ne nevojshme mjekësore dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

Policia dhe grupi hetimor kanë shkuar në vendin e ngjarjes për të mësuar e sqaruar rrethanat e plagosjes.

Në polici janë shoqëruar disa persona që dyshohet se kanë dijeni për plagosjen në fjalë. Ata po merren në pyetje dhe nga dëshmia pritet të zbardhen detaje në lidhje me autorët.

Nga ana tjetër, janë sekuestruar edhe pamjet filmike të lokalit “Kështjella”, që mund të kenë regjistruar plagosjen. Ilias Ismaili nuk rezulton të ketë precedent penalë dhe ende mbetet mister shkaku i plagosjes së tij.

n.s. / dita



May 21, 2021 21:42

Media Sociale
Ndaje me miqtë



Printoje

Nise me e-mail

Media Sociale
Ndaje me miqtë



Printoje


Nise me e-mail



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu



62.7K
NDJEKËS



12.2K
NDJEKËS



13.5K
NDJEKËS

1 KOMENT

Komento



Sketerre 2021

Pasi Shiti drogen dhe iku pa dhenur parate mbrapa,erdhi te beje investim ne Shqiperi,,ky eshte realiteti,,Shteti duhet te sekuestroje cdo gje qe eshte bere nga Droga,,dhe do behet nje Shtet i Pasur Goxha,,se 90% e pasurive dhe pronave ne shqiperi jane bere si ne kolumbine e Escobarit...keta shit droge e shteti vjel taksat nga investimet dhe pastrimet e parate se piste...

Reply to this comment



KOMENTO

Shiko komentet

Your e-mail address will not be published.
Required fields are marked *

Komenti *

Mesazhi juaj..

Nickname *

Nickname..

E-mail *

E-mail..

Website

Website..

Posto komentin